



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. \_\_\_\_ Prot  
\_\_\_\_. \_\_\_\_ 2019

Tiranë, më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data: 18.09.2019]

**1. Për: “TOP-OIL” SHA**

*Dibër, Peshkopi*

*Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të shpallur fitues*

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”- Mallra - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: “Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbime profilaktike” ndarë në tre lote, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: 115,046,684.20 (njëqind e pesëmbëdhjetë milion e dyzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzetë) Lekë pa TVSH, me numër reference të procedurës kryesore: REF-19841-04-26-2019.

Numri i referencës së Lotit III: **REF-19850-04-26-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës së Lotit III: **“Blerje vajra lubrifikant, alkool frenash dhe pastrues motori”** fondi limit i marrëveshjes kuadër është: **66,633,207.95** (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e shtatë pikë nëntëdhjetë e pesë një) lekë pa TVSH, me shumatore të çmimeve për njësi; **55,959.13** (pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë trembëdhjetë) lekë pa TVSH dhe me afat kohor për ekzekutimin:

- Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, sipas marrëveshjes kuadër.

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike 06.05.2019, Nr. 18.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët x**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

**1) “EXIMOIL” SHA**

**Emri i plotë i shoqërisë**

**Vlera** (shumatorja e çmimeve për njësi): **27,749** (njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet e

**K91715006E**

**numri i NIPT-it**

nëntë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

**2) “KAPPA OIL” SHA**

**J91402501L**

**Emri i plotë i shoqërisë**

**numri i NIPT-it**

**Vlera** (shumatorja e çmimeve për njësi): **35,360** (tridhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

**3) “KADIU” SHA**

**J61817045K**

**Emri i plotë i shoqërisë**

**numri i NIPT-it**

**Vlera** (shumatorja e çmimeve për njësi): **35,922** (tridhjetë e pesë mijë nëntë qind e njëzet e dy) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

**4) “ALSTEZO” SHA**

**J63208420N**

**Emri i plotë i shoqërisë**

**numri i NIPT-it**

**Vlera** (shumatorja e çmimeve për njësi): **42,360** (dyzet e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

**5) “TOP-OIL” SHA**

**K16604717F**

**Emri i plotë i shoqërisë**

**numri i NIPT-it**

**Vlera** (shumatorja e çmimeve për njësi): **37,800** (tridhjetë e shtatë mijë e tetë qind ) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë).

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

● **Arsyet e s’kualifikimit të “KAPPA - OIL” SHA**

1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1, të seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të shtojcës 9 të DT-së, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e këtij ofertuesi rezulton se nuk ka arritur të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit për këtë Lot.
2. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9 të DT-së, pasi:
  - Nga verifikimi i katalogut të prodhuesit në faqen 47, për artikullin me numër rendor 39, Vaj për kuti shpejtësie SAE 85W- 140, rezulton se OE nuk plotëson specifikimin teknik API GL-5 të përcaktuar në shtojcën nr.10 (Specifikimet teknike) të DT për këtë artikull, pasi në katalog është ofruar specifikimi teknik API GL-1.
  - Nga verifikimi i katalogut të prodhuesit në faqen 61 të tij, për artikullin me numër rendor 65, “Solucion për zhbllokim dhe pastrim radiator”, rezulton se OE ka ofruar produktin “KAPPA Radiator Stop Leak” i ndryshëm për sa i përket funksionit nga produkti i kërkuar pasi produkti i ofruar “KAPPA Radiator Stop Leak” aplikohet për bllokim të çarjeve të radiatorit, qëllim i kundërt nga ai i kërkuar për artikullin me numër rendor 65, “Solucion për zhbllokim dhe pastrim radiator”.
3. Nga verifikimi çmimeve për njësi të paraqitura në tabelën e përgjithshme të shtojcës nr. 1 (Formulari i deklaramit të ofertës) për artikujt me numër rendor 3; 4; 5; 9; 11; 12; 16; 17; 23; 24;

25 dhe 29 rezulton se për këto artikuj ofertuesi ka paraqitur cmimin për njësi të ndryshme në tabelat e vecanta të autoriteteve kontraktore si;

- DP Doganave për numrin rendor 3, 12, 17,
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për numrin rendor 4 dhe 5, 16 dhe 29.
- QSHAMT për numrin rendor 5, 9, 12, 23 dhe 24.
- Garda e Republikës për numrin rendor 5, 9, 11, 25.

• **Arsyet e s'kualifikimit të "KADIU" SHA**

1- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 6, në pikën 7 dhe në pikën 9 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9 të DT-së, pasi:

- Nuk arriti të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi për të gjithë artikujt e përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së dhe të deklaruar si prodhues në dokumentin e emërtuar "Skeda teknike".
- Nga verifikimi i dokumentave të hedhura si pjesë e ofertës së tij rezulton se ofertuesi ka paraqitur autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga "UAB SCT Lubricants", për 40(dyzetë)artikujt të përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së por, nuk rezulton që në këtë autorizim OE, të jetë i autorizuar nga ky prodhues për të tregëtuar edhe artikullin, Vaj motori për automjete, "SEA 0W-30", me nr. rendor 1 ne Tabelen e Pergjithshme te Vajrave ne Shtojcen 12, të cilin e ka deklaruar si të tillë në dokumentin e emërtuar "Skeda teknike".

- Nga verifikimi i dokumentave të hedhura si pjesë e ofertës së tij rezulton se ofertuesi ka paraqitur autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga "ROWE", për 9 (nëntë) artikujt të përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së por, nuk rezulton që në këtë autorizim OE, të jetë i autorizuar nga ky prodhues për të tregëtuar edhe artikullin, Vaj motori për automjete, "SEA 20W-50", me nr. rendor 29 ne Tabelen e Pergjithshme te Vajrave ne Shtojcen 12, të cilin e ka deklaruar si të tillë në dokumentin e emërtuar "Skeda teknike".

- Nga verifikimi rezultoi se OE nuk arriti të paraqesë **katalogë/ broshurë të vajra lubrifikant, alkool frenash dhe pastrues motorri**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara për artikullin Vaj motori "5W-30 4T", me numër rendor 32; Vaj për kuti shpejtësie "ATF 4 +", me numër rendor 42; antifrizë motorri -40, me numër rendor 55;
- Nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga OE, për këtë procedurë prokurimi, rezultoi se mostrat e artikujve: Vaj motori për motoçikleta, "5W-30 4T", me nr rendor 32 dhe Vaj motori për motoçikleta, "10W-30 4T", me nr rendor 33, ne Tabelen e Pergjithshme te Vajrave ne Shtojcen 12, nuk kanë tapa sigurie të dyfishta, *kerkesë e përcaktuar në në pikën 9 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9 të DT-së.*

2- Nga verifikimi cmimeve për njësi të paraqitura në tabelën e përgjithshme të shtojcës nr. 1 te DT, për artikullin me numër rendor 51 rezulton se ofertuesi ka paraqitur cmimin për njësi 290 lekë pa TVSH, i ndryshëm nga ai vendosur për këtë artikull tek tabela e vecantë e Autoritetit kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ku është deklaruar cmimi për njësi prej 230 lekë pa TVSH.

Gjithashtu, nga verifikimi i cmimeve për njësi të paraqitura në tabelën e përgjithshme të shtojcës nr. 1 për artikullin me numër rendor 53 rezulton se ofertuesi ka paraqitur cmimin për njësi 625 lekë pa TVSH, i ndryshëm nga ai vendosur për këtë artikull tek tabela e vecantë e

Autoritetit kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ku është deklaruar cmimi për njësi prej 450 lekë pa TVSH.

- **Arsyet e s'kualifikimit të "EXIMOL" SHA**

- 1- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 6, në pikën 7 dhe në pikën 9 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9 të DT-së, pasi:
  - nuk arriti të *provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi për të gjithë artikujt e përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së dhe të deklaruar si prodhues në dokumentin e emërtuar "Tabela e vajrave e shtojcës 12".*
  - *Nga verifikimi i dokumentave të hedhura si pjesë e ofertës së tij rezulton se ofertuesi ka paraqitur autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga "OLMA D.O.O" të datës 02.02.2019, për artikujt e markave të tij tregëtare "Olma" dhe "Slovenoil" të përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së por nuk rezulton të ketë paraqitur autorizim nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, "SUPERHELP", të deklaruar si të tillë në dokumentin e emërtuar "Tabela e vajrave e shtojcës 12", për artikujt me numrat rendor: 59; 60; 61; 62; 63; 64 dhe 65 referuar sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) të DT.*
  - Në katalogun e prodhuesit: "DOLMA D.O.O" nuk janë të pasqyruara të dhënat teknike dhe specifikimet teknike për artikujt për artikujt me numrat rendor: 1 dhe 20, referuar sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) të DT.
  - Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9 të DT-së, pasi nuk arriti të paraqesë **katalogë/ broshurë të vajra lubrifikant, alkool frenash dhe pastrues motorri**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Dokumenti i hedhur, si pjesë të ofertës dhe i emërtuar "Katalogu OLMA", dhe "SLOVEN KATALOG 2019" të cilët rezultojnë se janë edhe në gjuhën shqipe, por të panëshkruar nga përkthyes zyrtar dhe të pavertetura nga noteri publik.
  - Nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga OE, për këtë procedurë prokurimi, rezultoi se mostrat e artikujve : Vaj motori për automjete, "SEA 5W-30" me nr rendor 4; Vaj motori për automjete, "SAE 5W-40" me nr rendor 10; Vaj motori për automjete, "SAE 20W-50", me nr rendor 28; Vaj motori për motoçikleta, "5W-30 4T", me nr rendor 32 dhe Vaj motori për motoskafe, "TC W-3", me nr rendor 48, në Tabelen e Përgjithshme të Vajrave në Shtojcën 12, nuk kanë tapa sigurie të dyfishta, *kerkesë e përcaktuar në pikën 9 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9 të DT-së.*
  - OE Nuk arriti të paraqesë mostrën si dhe raport analizimin për artikullin: Vaj Armësh, "NATO CODE S-761", Vaj Armësh, S-758, MIL-PRF-63460E Amd.4, me nr rendor 50 në Tabelen e Përgjithshme të Vajrave në Shtojcën 12.

- **Arsyet e s'kualifikimit të "ALSTEZO" SHA**

- 1- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 6, në pikën 7 dhe në pikën 9 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9 të DT-së, pasi:
  - nuk arriti të *provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi për të gjithë artikujt e përfshirë në tabelën e*

*përgjithshme (shtojca 12) e DT-së dhe të deklaruar si prodhues në dokumentin e emërtuar "lista e vajrave që shoqëron katalogët teknik".*

- a) Nga verifikimi i dokumentave të hedhura si pjesë e ofertës së tij rezulton se ofertuesi ka paraqitur autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga "WOLF OIL CORPORATION" S.A të datës 27.05.2019, për të gjithë artikujt e përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së por nuk rezulton të ketë paraqitur autorizim nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, "ADINNOL", "CHAMPION", "RAVENOL", "CASTROL", "MOTUOL", "CYCLO" dhe "CHIMITEX", të deklaruar si të tillë në dokumentin e emërtuar "lista e vajrave që shoqëron katalogët teknik" për artikujt me numrat rendor: 4;5;10; 13; 14; 18; 32; 33; 48; 50; 56; 59; 60; 61; 62; 63; 64; 65; 66; 67 dhe 70, referuar sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) të DT.
- b) Në autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga "WOLF OIL CORPORATION" S.A të datës 27.05.2019, evidentohen të 72 artikujt e kërkuar, po në katalogun shoqërues të këtij prodhuesi nuk janë të pasqyruara të dhënat teknike dhe specifikimet teknike për artikujt për artikujt me numrat rendor: 13;18; 32; 33; 48; 50; 56; 59; 60; 61; 62; 63; 64; 65; 66; 67 dhe 70, referuar sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) të DT.
- Nuk arriti të paraqesë raport analizë për artikullin: Vaj për kuti shpejtësie "ATF G 052 162 /G 060 162", Dexron VI ose ekuivalent me nr rendor 43 ne Tabelen e Pergjithshme te Vajrave ne Shtojcen 10. OE rezulton të ketë paraqitur raport analizimi për: *Dextron III*.
  - Nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga OE, për këtë procedurë prokurimi, rezultoi se mostrat e artikujve: *Vaj motori për automjete, "SAE 5W-40 me nr rendor 10; Vaj motori për automjete, "SAE 15E-40", me nr rendor 22; Vaj motori për automjete, "SAE 20W-50", me nr rendor 28 në Tabelën e Përgjithshme të Vajrave në Shtojcën 12, nuk kanë tapa sigurie të dyfishta, kerkesë e percaktuar në në pikën 9 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9 të DT-së.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1) "TOP-OIL" SHA  
*Emri i plotë i shoqërisë*

**K16604717F**  
*numri i NIPT-it*

Vlera: **37,800** (tridhjetë e shtatë mijë e tetë qind ) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, menjëherë nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.06.2019

Ankesa: Po;

Kanë marrë përgjigje nga Organi Qendror Blerës në datë 26.06.2019.

Kanë marrë përgjigje nga KPP në datë 12.09.2019

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

